



Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 19.2 të *Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit*, të datës 30 Janar 2016 ("Ligji").

Konform Nenit 15. të *Rregullës për Përcaktim të Tarifave të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë* të datës 24 Dhjetor 2012 (Rregulla ZRRUK R-02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga NH "Iber-Lepenc" Sh. A. Prishtinë për procesin tariforë 2015-2017 dhe qëndrueshmërisë së saj financiare dhe analizave të të dhënave të realizuara të performancës së KRU-ve që i furnizon IL-ja, lëvizjeve inflatore në vend të periudhës Dhjetor 2014 – Nëntor 2015 dhe rrethanave socio ekonomike në vend.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) lëshon këtë:

## URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

**PËRCAKTIM I TARIFAVE PËR FURNIZIM TË UJIT ME SHUMICË TË PA TRAJTUAR PËR APLIKIM NGA NH "IBËR-LEPENC" SH. A. PRISHTINË PËR KRU "MITROVICA" SH. A. MITROVICË DHE KRU "PRISHTINA" SH. A. PRISHTINË, GJATE PERIUDDHES TARIFORE 01. 06. – 31. 12. 2016 NGA PROCESI TARIFORE 2015-2017**

### 1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

### 2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për aplikim nga NH "IBER-LEPENC" Sh. A., me rastin e faturimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pa trajtuar me shumicë, për dy ujësjetës regional, dhe atë për; KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë dhe KRU "Prishtina" sh. a. Prishtinë për njësinë e Dranasit.

ARRU mund t'i bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së bazuar të NH "IBER-LEPENC" Sh. A.. në pajtim me nenin 15. dhe 16. të Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

### 3. Pasqyra e Tarifave të Shërbimit 2015-2017

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë për konsumatorët e vet do të aplikojë Tarifat e Shërbimit për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar gjatë periudhës tarifore **01. 06 gjerë me 31. 12. 2016** nga procesi i rregullt tariforë tri vjeçare 2015-2017 sikurse janë dhënë në Tabelën e më poshtme:

Tabela :: Tarifat rregullatore për periudhën tarifore 2015-2017

Numri rendor	KRU-të	Njësia tarifore	Tarifat bazë për vitet			Tarifat e aplikueshme për vitet		
			2015	2016	2017	2015	2016	2017
1	Mitrovica	€/m <sup>3</sup>	0.0184	0.0184	0.0184	0.0184	0.0184	-
2	Prishtina	€/m <sup>3</sup>	0.0455	0.0455	0.0455	0.0455	0.0455	-

### 4. Afati i aplikimit

Tarifat e vitit 2016 do të aplikohen sipas Tabelës së mësipërme nga: **01. 06 - 31. 12 2016**, Tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa TVSH.

### 5. Procedurat e rishikimit të tarifave

Tarifat e aplikuara për vitet 2016 dhe 2017 mund të rishikohen për përcaktim dhe aplikim gjatë vlefshmërisë së tarifave të këtij procesi rregullatorë të periudhës së mbetur 3 vjeçare 2015-2015, në përputhje me aktet rregullative të ARRU-së, duke marr në konsideratë; performancën e saj dhe të KRU-ve, shkallen e lëvizjeve inflatore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë, publikuar nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës për periudhën e shikuar; viti 2016 - periudha inflatore dhjetor/2014 – nëntor/2015, dhe për vitin 2017 për periudha inflatore dhjetor/2015 – nëntor/2016 dhe rrethanave socio ekonomike në vend.

### 6. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

NH "IBËR-LEPENC" Sh. A. Prishtinë duhet të njoftojë Kompanitë e Ujësjetësve Regjional të cilat i furnizon me ujë të pa-trajtuar me shumicë me Tarifat e Shërbimit të përcaktuara nga ARRU-ja, sipas kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit, me rastin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose tu dërgojë të njëjtave kopjen e saj me faturën e radhës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit të vet; [www.arru-rks.org](http://www.arru-rks.org).

### 7. Apelet

NH "IBER-LEPENC" Sh. A., ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda një muaj, nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 41.1, Komisioni Shqyrtues, Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të datës 30 Janar 2016.

### 8. Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve të gjuhëve të ndryshme, mbizotërojnë versionet në gjuhën shqipe.



Raif Preteni  
Drejtor i ARRU

